VENDIM
Nr. 38, datë 13.7.2016

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA E DYTË, NGA GRANTI "SHQIPËRIA DIXHITALE", PROGRAMI "SHQIPËRIA DIXHITALE", SHTYLLA III, E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e dytë, për vitin 2016, për grantin "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas tabelës 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik të projektit dhe të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe perio-dikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inova-cionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e dytë për vitin 2016, përmes grantit 1: "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (Financim nga FZHR).

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
1	Bashkia Ura Vajgurore	Platforma ëeb GIS Bashkia Ura Vajgurore , Teknika të avancuara replikimi	10 000 000	10 000 000
2	Bashkia Vlorë	Vlerësimi dhe hedhja e të dhënave gjeohapsinore ekzistuese në platformën e Sistemit Gjeografik të (GIS)	15 000 000	15 000 000
3	Bashkia Mallakastër	Implementimi i Sistemit të taksave dhe tarifave vendore për qytetarin dhe biznesin e Bashkisë Mallakastër	9 100 000	9 100 000
4	Bashkia Fier	Ngritja e portalit të administrimit dhe promovimit të atraksioneve kulturore-historike dhe turistike në Bashkinë e Fierit	14 930 000	14 930 000
5	Bashkia Çorovodë	Informimi *on-line* i qytetarit dhe biznesit mbi detyrimet për taksat vendore, nëpërmjet implementimit të sistemit të taksave për Bashkinë Çorovodë dhe njësitë administrative të saj, si dhe infrastruktura mbështetëse.	9 899 000	9 899 000
6	Bashkia Korçë	Qyteti im (Bashkia Korcë, Bashkia Elbasan, Bashkia Përmet)	40 000 000	40 000 000
7	Bashkia Elbasan	Transporti inteligjent (Bashkia Elbasan, Bashkia Korcë, Bashkia Vlorë)	45 000 000	45 000 000
8	Bashkia Durrës	Modernizimi i shërbimit të informimit të qytetarëve nëpërmjet dixhitalizimit dhe standartizimit të të dhënave gjeohapesinore të titujve të pronësisë dhe bizneseve të Bashkisë Durrës	15 000 000	15 000 000
9	Bashkia Kolonjë	Administrimi financiar dhe menaxherial i Bashkisë Kolonjë dhe njesive administrative të saj	8 600 000	8 600 000
10	Bashkia Berat	SMART CITY Kioskat informuse dhe akses interneti ëifi në qytetin e Beratit.	14 650 000	14 650 000
	Totali		**182 179 000**	**182 179 000**

Shënim:

1. "Vlera e projektit", është vlera e kërkuar në aplikim nga autoriteti kontraktues, për t'u alokuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për zbatimin e projektit. Kjo vlerë korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet, për financimin e projekteve të reja dhe/ose në vazhdim. Vlera e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).

2. "Vlera e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016, në këtë vendim.

3. Për projektet nr.6 dhe nr.7, projekti është i përbashkët për 3 bashki, ku vlera e projektit për bashki është bashkuar në një projekt, me vlerë kumulative financimi. Përcaktimi i bashkisë, si autoriteti kontraktues, i projektit të plotë, është bërë në marrëveshjen e bashkëpunimit, midis bashkive, dhe paraqitur në sekretariatin teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

4. Autoritetet kontraktuese të projekteve fituese, përpara nisjes së procedurave të prokurimit, duhet të marrin paraprakisht miratimin e termave të referencës së projekteve që do të zbatojnë, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila duhet të përmbyll procesin e miratimit brenda 10 ditëve nga data e kërkesës së autoritetit kontraktues. Për projektet nr.6 dhe nr.7, në të cilat përfshihen një grup bashkish përfituese, duhet që të depozitohet pranë sekretariatit teknik, gjithashtu, marrëveshja për mbulimin e përbashkët të kostos së mirëmbajtjes së projektit. Kërkesat e mësipërme janë paraqitur nga sekretariati teknik (Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike), dhe janë kusht për çeljen e fondeve dhe për vazhdimin e procedurave të zbatimit të projektit.

Tabela 2. Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e dytë për vitin 2016, përmes grantit 1: "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (Bashkëfinancim me FZHR-në).

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (në Lekë)	Vlera e financimit e kërkuar nga FZHR (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
1	Bashkia Tiranë	Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë e Tiranës	51 696 000	30 000 000	30 000 000
2	Bashkia Tiranë	Linearizimi financiar në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë	49 728 000	30 000 000	30 000 000
3	Bashkia Tiranë	Sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të aseteve të Bashkisë Tiranë	52 824 000	30 000 000	30 000 000
4	Bashkia Tiranë	Linearizimi i menaxhimit të aseteve në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë	53 568 000	30 000 000	30 000 000
5	Bashkia Elbasan	Projekt i monitorimit të ambientit në qytetin e Elbasanit	24 565 000	14 965 000	14 965 000
6	Bashkia Durrës	Platforma multifunksionale e informacionit për turistët dhe qytetarët përmes ëeb, infokiosk dhe aplikacion *mobile* (Bashkia Durrës, Bashkia Kavajë, Bashkia Krujë)	40 000 000	28 000 000	28 000 000
	Totali		**272 381 000**	**162 965 000**	**162 965 000**

Shënim:

1. "Vlera e projektit", përfaqëson vlerën kumulative të projektit, midis financimit të kërkuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerës së bashkëfinancimit të autoritetit kontraktues, të deklaruar në aplikimin për financim, për zbatimin e projektit. Kjo vlerë korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj, dhe diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, duhet të zbritet propocionalisht nga financimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe nga autoriteti kontraktues, sipas kontributit respektiv. Fondi i përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit "infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose në vazhdim. Vlera e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).
2. "Vlera e financimit e kërkuar nga FZHR-ja", është vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktues, për zbatimin e projektit, për t'u alokuar nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.
3. "Vlera e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, në këtë vendim.
4. Për projektin nr. 6, projekti është i përbashkët për 3 bashki, ku vlera e projektit për bashki është bashkuar në një projekt, me vlerë kumulative financimi. Përcaktimi i bashkisë, si autoriteti kontraktues, i projektit të plotë, është bërë në marrëveshjen e bashkëpunimit, midis bashkive, dhe paraqitur në sekretariatin teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.
5. Autoritetet kontraktuese të projekteve fituese, përpara nisjes së procedurave të prokurimit, duhet të marrin paraprakisht miratimin e termave të referencës së projekteve që do të zbatojnë, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila duhet të përmbyll procesin e miratimit brenda 10 ditëve nga data e kërkesës së autoritetit kontraktues. Për projektin nr.6, ku përfshihet një grup bashkish, duhet që të depozitohet pranë sekretariatit teknik, gjithashtu, marrëveshja për mbulimin e përbashkët të kostos së mirëmbajtjes së projektit. Kërkesat e mësipërme janë paraqitur nga sekretariati teknik (Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike), dhe janë kusht për çeljen e fondeve dhe për vazhdimin e procedurave të zbatimit të projektit.